

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić, anëtarë me bashkëpunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

**R. D. Č.**, Novi Beograd, Serbi

**Kundër: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Rexhep Mala” nr. 2, Prishtinë**

Duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK), KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës ( më tej AKP), me numrin KPA...), pas shqyrtimit të mbajtur me datë 08 Maj 2019, mori këtë:

### AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. Č. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 (kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA...) i datës 21 Tetor 2014.
2. Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/260/2014, i datës 21 Tetor 2014, sa i përket kërkesës me numrin KPA...

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 8 Mars 2007, R. Č. (në tekstin e mëtejme, pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën ka kërkuar kthimin e posedimit të ngastrave kadastrale nr. ..., ... dhe ..., me kulturë arë e klasit të gjashtë dhe livadh i klasit të katërt me sipërfaqe të përgjithshme prej 1.05.92 ha., Zona Kadastrale Fushë Kosovë, (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Pala Ankuese thekson se është bashkëpronarë me pjesë ideale prej 1/3, me M. D. Dj. dhe D. D. S..
2. Së bashku me kërkesën kishte dorëzuar në AKP *mes tjerash* dokumentet vijuese;
  - Aktgjykimin P.br.619/95,të datës 31 Janar 1997 me të cilën Kombinati Bujqësor “Poljoprivreda”,Fushë Kosovë, obligohej ti kthente palës ankuese pronën objekt i kontratës Ov.... datë 16 Tetor 1963 e lidhur mes Kombinatit Bujqësor dhe Andja Biga. Ky aktgjykim e anulonte kontratën e lidhur në vitin 1963 dhe i kthente tokën palës ankuese dhe familjarëve të saj.

- Autorizimin e dhënë nga pala ankuese për Avokat F. S. nga Beogradi.
  - Shkresën e të autorizuarit drejtuar AKP-së, që dëshmon se disa ngastra janë shitur (jo prona e kërkuar).
3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte bërë njoftimin për kërkesën me datë 27 Mars 2008 dhe 1 Korrik 2010, ku ishte gjetur se prona e kërkuar ishte kullose. Me 1 Korrik 2010 njoftimi për kërkesën ishte publikuar në gazetën nr. 3 të AKP-së, po ashtu ishte shpërndarë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, zyrën kadastrale, në UNHCR, zyra rajonale Danish Refugee Council, Komuna e Obiliqit etj.
  4. Me 23 Dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e Privatizimit me shkresën Nr 115009 duke u pergjigjur kërkesë së AKP-së të datës 18 dhjetor 2013 njofton se prona e kërkuar është nën administrimin e Agjencisë dhe se i është nënshtruar procesit të likuidimit me datën 4 Gusht 2010 është caktuar autoriteti likuidues i ndërmarrjes Shoqërore.
  5. Sipas raportit të verifikimit të Sekretarisë të AKP-së, të datës, 1 Gusht 2014, është verifikuar pozitivisht Aktgjykimi P.Br.619/95, ndërsa shenimet kadastrale deri para likuidimit tregojnë se prona ka qenë e evidentuar si pronë shoqërore e Kombinatit Bujqësor.
  6. Sekretaria ka gjetur se sipas Certifikatës për paluajtshmeri me numër.Ul...., lëshuar nga zyra kadastrale Fushe Kosovë , e datën 14 Korrik 2009, e cila paraqet pronën e kërkuar të regjistruar në emra të shfrytëzuesve tjerë.
  7. Me 3 Shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit, me shkresën informuese i është drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronave, Gjykatës Komunale dhe Dhomës së Posaçme se Kombinati Bujqësor aset i të cilit ishte prona e kërkuar është në procesin e likuidimit.
  8. Më 21 Tetor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/260/2014 (në tekstin e mëtejme: (Vendimi i KKPK-së), e ka hedhë poshtë kërkesën për shkak të faktit se në bazë të verifikimit nga sekretaria *ex officio*, kjo çështje binte jashtë juridiksionit të Komisionit, sipas arsyeve në arsyetimin e vendimit të saj në paragrafët 19 dhe 20, nga shkak se Prona e kërkuar evidentohet si shoqërore në pronësi të Ndërmarrjes Bujqësore, dhe e vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit,(AKP-së), në vitin 2002 në bazë të miratimit të rregullores së UNMIK 2002/12 e ndryshuar me rregulloren e UNMIK 2005/18,dhe sipas përfaqësuesit t AKP-së, e cila ishte në proces të likuidimit dhe Juridiksioni për pronat e kërkuara bie mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme te Kosovës sipas nenit 4.1 dhe 5.1, të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.
  9. Vendimi i KKPK-së, i ishte dorëzuar paraqitëses së kërkesës(në tekstin e më tejme pala ankuese), me datë 03 Mars 2015, e njëjta kishte paraqitur ankesë më 24 Mars 2015. Palës përgjegjëse në ankesë i është dorëzuar vendimi i KKPK-së, me 20 Shkut 2015.

10. Me 22 Qershor 2016 u njoftua pala përgjegjëse me një kopje të ankesës dhe nuk u përgjigj ne afatin e parapare ligjor

### **Pretendimet e palës ankuese**

11. Pala ankuese thekson se; Vendimi i KKPK-së, përmban shkelje thelbësore të rregullave procedurale, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vërtetim jo të saktë dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat shkelje janë të rëndësishme për vendosje lidhur me kërkesën për vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin e posedimit në pasurinë bujqësore, e që nga kjo rezulton se Vendimi i KKPK është jo i drejtë dhe ligjor.
12. Pala ankuese tutje në ankesë kryesisht e përshkruan rrjedhën e procedurës sipas kërkesës së tij të ushtruar në KKPK, të drejtën në pronën e kërkuar në tërësi e bazon në dokumentet të cilat ja ka bashkangjitur kërkesës, duke i përshkruar faktet sipas këtyre dokumenteve, në bazë të cilave pretendon se është pronare legjitime e pronës së kërkuar, ndërsa vlerëson se nuk është me rëndësi në këtë procedurë që në kadastër nuk janë bërë ndryshimet sepse këtë pronë e ka pas në posedim pas vendimit gjyqësor e që ma pastaj kjo pronë është uzurpuar, ndërsa AKP e ka marrë vetëm për bazë se në kadastër kjo pronë evidentohet si Pasuri shoqërore në emër të Kombinatit Bujqësor.
13. Në fund pala ankese kërkon që Gjykata Supreme pas shqyrtimit dhe vërtetimit të fakteve dhe provave, të nxjerrë vendim me të cilin e anulon vendimin e ankimuar të KKPK të aprovet kërkesa e saj dhe pasurin e uzurpuar në mënyrë jo ligjore ti kthehet në posedim.

### **Arsyetimi ligjor**

#### **Pranueshmëria e ankesës**

14. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së.

#### **Meritat e ankesës**

15. Gjykata Supreme, shqyrtoi Vendimin e ankimuar dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr,03/L-006, konstaton se Vendimi KKPK-së, nuk është i përfshirë me asnjë lëshim thelbësor procedural, zbatim të gabuar të së drejtës së

- aplikueshme materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve ashtu si theksohet në ankesë. Prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.
16. Në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare nr.6/80), në fuqi në kohën kur është P.br.619/95 i datës 31 Janar 1997, e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (transferim juridik) dhe me trashëgimi.
  17. Megjithatë, neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80), përcakton se në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/1-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 pika 1 parasheh se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.
  18. Kjo çon në konkludimin se prindi ushturesi i kërkesë në AKP apo familja e palës ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që nuk janë plotësuar kushtet e neneve 20 dhe 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80).
  19. Vendimi KKPK-së për hudhjen e kërkesës në mungesë të Juridiksionit është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Shënimet e gjetura nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, të theksuara si më lartë, dhe nga shkresa informuese e Agjencisë Kosovare të privatizimit, konfirmohet se prona e kërkuar trajtohet si pronë shoqërore në emër të KB “Kosova Eksport”, dhe si e tillë i ishte nënshtruar procesit të likuidimit. Nga kjo rezulton se juridiksioni bie ekskluzivisht mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c), dhe nenit 5.1 (a), të Rregullores së UNMIK, për Dhomën e Posaçme 2008/4, e amendamentuar me Ligjin nr. 04//L-033, dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji përkundër pohimit të palës ankuese se nuk ka inicuar procedurë në Dhomën e Posaçme qartazi del se juridiksioni është ekskluzivisht përjashtues për AKP-në, dhe bie mbi Dhomën e Posaçme.
  20. Prandaj në këtë rast konkret e në pajtim me nenin 11.4, nën (b), të Rregullores së Unmik-ut, e miratuar me Ligjin nr.03/L-079, për shkak të mungesës së sferës së juridiksionit ,kërkesa është hedhur poshtë si në vendimin e ankimuar dhe rrjedhimisht nuk është vendosur për meritat e çështjes që i referohen objektit të kërkesës.
  21. Mbi faktet e cekura në paragrafët më lartë, Gjykata Supreme konkludon se vendimi i KKPK-së është i drejtë, i ligjshëm me të cilin janë dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes. Vendimi ankimor nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të ligjit material dhe procedural ,sipas nenit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, andaj ankesa refuzohet si e pabazuar, ndërsa

vendimi ankimor i KPCC, vërtetohet si drejtë dhe i ligjshëm sipas nenit 13.3 (c), Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

22. Ky aktgjykim i nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtën e saj pran organit kompetent, apo gjykatës kompetente nëse ajo e vlerëson me interes ligjor.

**Këshillë ligjore;**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**GSK-KPA-A-017-2016 me datën 08 Maj 2019**

**Bashkp. Profesional**  
**Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit**  
**Beshir Islami**